



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.11.2018, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi nën për nën i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Luan Duzha, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Elona Hoxha, Paulin Sterkaj, Anduel Xhindi, Klodjana Spahiu, dhe Antoneta Dhima .

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Myslym Murrizi, Ervin Saliq, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunkshi, Isuf Çelaj

Të ftuar:

Petro Koçi – Zëvendësministër i Mbrojtjes

Nuri Laknori - Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MM

Mirjana Zisi - Drejtoresha e Financave së Ministrisë së Drejtësisë.

Enkeleda Peka - Drejtore e Drejtorisë Juridike të SHISH-it.

Romina Peçi - Drejtore e Drejtorisë Ekonomike dhe Administrimit SHISH

Ina Dhaskali – Përgjegjëse sektori në drejtorinë e buxhetit, Ministria e Financave

Valion Cenalia - Specialist në drejtorinë e buxhetit, Ministria e Financave

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Hapim mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës kemi parashikuar diskutimin dhe miratimin nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.

Javën e shkuar ne kemi ezauruar të gjithë procedurën e prezantimit të buxhetit të vitit 2019 dhe natyrisht kemi pasur seanca dëgjimore me secilin prej institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes.

Kemi përgatitur një raport të hollësishëm sipas kërkesave që kanë paraqitur të gjitha institucionet që kanë gjetur mbështetje nga anëtarët e këtij komisioni.

Raportin ia kemi përcjellë Komisionit të Ekonomisë. Do të uroja që edhe në atë komision ato kërkesa të gjejnë reflektim në kuptimin që të mbështeteshin maksimalisht.

Sot, për të diskutuar dhe për të miratuar nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”, kemi të ftuar zotin Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes; zotin Nuri Laknori, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Mbrojtjes; zonjën Mirjana Zisi, drejtoreshë e financave në Ministrinë e Drejtësisë; zonjën Enkeleda Peka, drejtore e Drejtorisë Juridike e SHISH; zonjën Romina Peçi, drejtore e Drejtorisë Ekonomike dhe Administrimit në SHISH; zonjën Ina Dhaskali dhe zotin Valion Cenalia, të dy specialistë të buxhetit në Ministrinë e Financave.

Faleminderit të gjithëve!

Atëherë, kalojmë direkt në diskutimin dhe miratimin nen për nen të projektbuxhetit.

Neni 1. A ka diskutime? Vërejtje? Pyetje? Nuk ka.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6. Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2019.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8. Të ardhurat e buxhetit të shtetit të ndara në grupe.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në kreun e tretë të ligjit. Shpenzimet e buxhetit të shtetit.

Neni 10. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11, që bën fjalë për numrin e përgjithshëm në organikë, që rezulton të jetë 82022 veta.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12. Paga e Presidentit të Republikës. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13. Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14, parashikon rritjen e pagave, nga ku do të përfitojnë edhe ushtarakët, që është rritje e ndjeshme nga ushtari i thjeshtë deri të grada “major”. Rritje ka edhe në sektorë të tjerë.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17. Buxheti për arsimin e lartë.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21, që ka të bëjë me emetimin e eurobondeve.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23, që është hyrja në fuqi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në fakt, edhe për shkak të natyrës që ka, votimi nen për nen është një votim formal, më shumë rëndësi ka pasur pjesa e parë e prezantimit në parim dhe kërkesave që ne kemi mundur të dëgjojmë nga çdo institucion, por procedura e Rregullores na kërkon të bëjmë edhe këtë hap.

Urdhëroni, zoti Koçi!

Petro Koçi – Siç dihet, është rakorduar edhe me zyrën e Kryeministrit dhe me Ministrinë e Financave që buxheti për mbrojtjen të shkojë nga 1,20 të GDP-së në 1,25, kështu që do të kërkoja që kjo rritje në formën e kërkesës nga komisioni juaj t'i kalojë Komisionit të Ekonomisë dhe Financës. Pra, të kihet parasysh kjo kur të dërgohet raporti te ai komision.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Në fakt, gjatë mbledhjes ku është prezantuar buxheti për Ministrinë e Mbrojtjes të gjitha sqarimet kanë qenë më se të hollësishme dhe në këtë mënyrë ne i kemi reflektuar edhe te raporti që i kemi përcjellë Komisionit të Ekonomisë. Kjo vlen qoftë për Ministrinë e Mbrojtjes, qoftë për çdo institucion tjetër.

Kalojmë në miratimin në tërësi të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA